

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM
Nr.451, date 9.7.2004

PER KRITERET DHE MASEN E TRAJTIMIT FINANCIAR TE USHTARAKUT
AKTIV TE FORCAVE TE ARMATOSURA, KUR LIROHET NGA SHERBIMI NE
KETO FORCA PER ARSYE SHENDETESORE

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 29 te ligjit nr.9210, date 23.3.2004, "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", me propozimin e ministrit te Mbrojtjes, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtaraku aktiv i Forcave te Armatosura, kur semuret ne detyre ose per shkak te detyres, dhe kur vertetohet me raport te Komisionit te Larte Mjekesor te Spitalit Universitar Qendror Ushtarak, lirohet nga sherbimi ne Forcat e Armatosura dhe perfiton trajtim financiar deri ne punesimin e tij ose ne daljen ne pension te plote pleqerie.
2. Te drejten e trajtimit sipas ketij vendimi e kane ushtaraket qe kane vjetersi sherbimi jo me pak se 3 (tre) vjet ne keto forca dhe trajtohen me pagen baze per grade si me poshte vijon:
 - a) Oficeret trajtohen me pagen baze per grade te nentogerit me vite sherbimi nen 2 vjet;
 - b) Nenoficeret trajtohen me pagen baze per grade te nentetarit me vite sherbimi nen 2 vjet;
 - c) Ushtaret profesioniste trajtohen me pagen baze per grade te ushtarit profesionist I me vite sherbimi nen 2 vjet.
3. Ushtaraku e perfiton kete page deri ne çastin e punesimit ose te plotesimit te kushteve per pension te parakohshem per vjetersi sherbimi apo pensioni pleqerie. Pagesa te behet prane reparteve ushtarake, ku ushtaraku ka kryer sherbimin.
4. Ky trajtim financiar nderpritet nese ish-ushtaraku refuzon vendin e punes qe i ofrohet nga zyrat perkatese te punes dhe nese deklarohet i afte nga ana mjekesore nga Komisioni Mjekesor i Larte ne Spitalin Universitar Qendror Ushtarak.
5. Ushtaraku ka te drejten e zgjedhjes ndermjet ketij trajtimi financiar dhe trajtimit me pagese kalimtare, sipas nenit 10 te ligjit nr.8087, date 13.3.1996, "Per sigurimin shoqeror suplementar te ushtarakeve te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise, te Ministrise se Rendit Publik, Sherbimit Informativ Shteteror dhe te ish-Ministrise se Brendshme", te ndryshuar.
6. Periudha e trajtimit financiar, ne zbatim te ligjit nr.7703, date 11.5.1993, "Per sigurimet shoqerore ne Republikën e Shqiperise", te ndryshuar, quhet periudhe sigurimi. Kontributet per sigurimin shoqeror te ketyre ushtarakeve te perballohen nga fondet e miratuara per Ministrine e Mbrojtjes.
7. Personat perfitues te ketij trajtimi financiar duhet t'i nenshtrohen nje here ne vit rivleresimit mjekesor nga Komisioni Mjekesor i Larte ne Spitalin Universitar Qendror Ushtarak.

8. Efektet financiare per vitn 2004 qe arrijne shumen 2 400 000 (dy milione e katerqind mije) leke, te perballohn nga buxheti. i ketij viti, miratuar per Ministrine e Mbrojtjes.

9. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Punes dhe i Çeshtjeve Sociale per nxjerrjen e udhezimit perkates ne zbatim te ketij vendimi.

10. Pika 2 e vendimit nr.86, date 12.3.1992, te Keshillit te Ministrave, "Per disa te drejta e detyrime te ushtarakeve, te cilat rrjedhin nga ligji "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

**KRRYEMINISTRI
FATOS NANO**

**MINISTRI I MBROJTJES
PANDELI MAJKO**